Kronikë

Sarandë/ Tentoi të shiste një kallashnikov, arrestohet në flagrancë 34-vjeçari dhe bashkëpunëtori i tij

Një 34-vjeçar është arrestuar nga policia ditën e sotme pasi kap në flagrancë me armë zjarri kallashnikov, të cilën dyshohet se do ta shiste në qytetin e Sarandës.

[Sh.com] Redaksia
31 Mars, 11:44 | **Përditësimi: 31 Mars, 13:48**

Share

SARANDË - Një 34-vjeçar është arrestuar nga policia ditën e sotme pasi kap në flagrancë me armë zjarri kallashnikov, të cilën dyshohet se do ta shiste në qytetin e Sarandës.

Përpos 34-vjeçarit të identifikuar me inicialet E.M. është arrestuar gjithashtu dhe një 31-vjeçar i identifikuar me inicialet E.Sh., i cili dyshohet se do të ndihmonte 34-vjeçarin, për të shitur armën.

Arma e zjarrit kallashnikov iu gjet 34-vjeçarit gjatë kontrollit në automjetin tip "Audi", ndërsa 31-vjeçari është kapur nga shërbimet e Policisë ndërkohë që drejtonte një automjet tip "Ford".

[Sh.com]
LEXO EDHE:
U vetëdorëzua, gjykata lë në burg ish drejtorin e ALUZINI-t të Sarandës! Ndërtoi pa leje një hotel 7-katësh dhe e legalizoi

> *"E. M., 34 vjeç, banues në Sarandë, pasi gjatë kontrollit në automjetin tip "Audi", që ai drejtonte, shërbimet e Policisë gjetën 1 armë zjarri kallashnikov dhe 1 krehër me municion luftarak, të cilat dyshohet se ky shtetas do t'i shiste në qytetin e Sarandës;*
>
> *E. Sh., 31 vjeç, banues në Sarandë, pasi nga veprimet hetimore dyshohet se do të ndihmonte shtetasin E. M., për të shitur armën e zjarrit. Ky shtetas është kapur nga shërbimet e Policisë ndërkohë që drejtonte një automjet tip "Ford",-njoftojn policia.*

Arma e zjarrit kallashnikov, 1 krehër me municion luftarak dhe 2 automjetet e shtetasve të arrestuar, u sekuestruan në cilësinë e provës materiale.

K.M/E.B/Shqiptarja.com

TAG: sarande

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

[SH.COM]
Sondazhi i ditës:
Himara me kryebashkiake të komanduar, a është zgjidhja e duhur?

PO JO NUK E DI

Lajme të tjera

Dhjetëra turistë vendas e të huaj në bregdetin e jugut! Ukrainas e polakë në Ujin e Ftohtë: Këtu është një mrekulli

30 Mars, 15:02

Plazhi 'Pasqyrat' në Ksamil ka ujin më blu në botë, lë pas edhe Greqinë!

29 Mars, 10:17

Ish ministri dhe ish kryebashkiaku i Sarandës Stefan Çipa në SPAK (VIDEO)

28 Mars, 13:03

U mbollën dy vite më parë, thahen pishat në Sarandë! Drejtori i gjelbrimit: Mund të jetë prishur rrënja nga pakujdesia në transport

Limos Didani

27 Mars, 18:43

Ndërtoi pa leje një hotel 7-katësh dhe e legalizoi, vetëdorëzohet ish-Drejtori i ALUZINI-t në Sarandë

27 Mars, 16:42

Himarë/ Ndërtoi pa leje në plazhin e Shpellës, vihet nën hetim 50-vjeçari

24 Mars, 15:26

Sarandë, mungesa e mbikalimit burim për aksidente! Nga Metoqi në Central pa vendkalim për këmbësorët

Limos Didani

24 Mars, 15:02

Gjirokastër/ Ekspozita për Festën greke, arti bën bashkë shqiptarët dhe minoritarët

Piro Nase

22 Mars, 16:01

FOTOT/ Rigjenerim urban në Sarandë

21 Mars, 19:22

Zbardhet dosja, si u falsifikua dokumenti i inxhinierëve dhe si u ndërtua e legalizua hoteli 7-katësh i ish-drejtorit të ALUZINI në Sarandë

Limos Didani

21 Mars, 17:26

Sarandë/ Ndërtuan pa leje në Ksamil, arrestohen nëne e bir

21 Mars, 16:20

VIDEOLAJM/ Kamionin nuk e mbajnë frenat dhe as betoni në aksin Kardhiq-Delvinë

21 Mars, 09:25

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com
Gettutto

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje